

Si të shfrytëzoni kujdesin mjekësor në komunitetin tuaj si azilkërkues

Të drejtat tuaja për kujdes mjekësor

Pjesa më e madhe e kujdesit mjekësor në Mbretërinë e Bashkuar sigurohet nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (NHS).

Azilkërkuesit në Mbretërinë e Bashkuar kanë të njëjtat të drejta për kujdes shëndetësor falas nga NHS-ja si qytetarët e Mbretërisë së Bashkuar.

Kjo përfshin:

- vizitën te një mjek ose infermier
- vajtjen në spital
- bërjen e analizave
- sigurimin e kujdesit për shëndetin mendor
- thirrjen dhe përdorimin e autoambulancës.

Nëse ju është refuzuar azili dhe nuk keni një apelim aktiv, mund të ketë kufizime në lidhje me kujdesin falas që mund të siguronit (shih Azilkërkuesit e refuzuar më poshtë).

Ju keni të drejtën të keni një përkthyes që do të përkthejë në gjuhën tuaj. Mos keni frikë të kërkonit një përkthyes kur siguronit kujdes mjekësor. Kjo do t'ju ndihmojë juve dhe njerëzit që kujdesen për ju për të kuptuar siç duhet njëri-tjetrin.

Ju keni të drejtën e konfidencialitetit. Kjo do të thotë që të dhënat tuaja mjekësore nuk do të ndahen jashtë ekipit mjekësor që ju trajton, pa pëlqimin tuaj, përveç rastit kur ata janë të shqetësuar se ju ose një person tjetër jeni në rrezik serioz ose nëse është kryer një krim i rëndë.

Ndonjëherë, NHS-ja mund të ndajë emrin tuaj, adresën dhe datën e lindjes me Ministrinë e Brendshme në disa rrethana, për shembull nëse ata po përpiqen të zbulojnë nëse keni të drejtën për kujdes spitalor falas.

Azilkërkuesit e refuzuar (vetëm në Angli)

Nëse kërkesa juaj për azil është refuzuar dhe nuk keni një apelim aktiv, mund të ketë kufizime për sa i përket kujdesit shëndetësor falas që keni të drejtë të siguronit në Angli. Kjo ka të bëjë kryesisht me spitalet ose kujdesin e specializuar. Por ju do të keni sërish të drejtën e një farë kujdesi shëndetësor falas, duke përfshirë:

- vizitën dhe trajtimin nga një mjek i përgjithshëm
- kontracëpsion falas
- kujdes falas në raste urgjente tek Urgjenca Mjekësore ose qendrat e kujdesit për raste urgjente
- analiza falas dhe trajtim për sëmundjet infektive, duke përfshirë koronavirusin
- imunizim falas kundër koronavirusit.

Nëse jetoni në Irlandën e Veriut, Skoci ose Uells, keni të drejtën e shtrimit në spital falas dhe për kujdes të specializuar edhe nëse kërkesa juaj është refuzuar.

Pas një kërkesë të refuzuar, mund të gjeni më shumë informacione në lidhje me të drejtën tuaj për kujdes shëndetësor, këtu: <https://docs.google.com/document/d/11cKMCy08ebN-IJQsP1jvsTcSfwC6YeE8FYrmAZCoZ1w/edit>.

Regjistrimi te një mjek i përgjithshëm

Të gjithë ata që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar (pavarësisht nga statusi i emigrimit) mund të regjistrohen në një klinikë të mjekut të përgjithshëm në zonën ku jetojnë. Shpesh, njerëzit në Mbretërinë e Bashkuar e quajnë klinikën e mjekut të përgjithshëm “praktikë” ose “klinikë të lagjes”.

Mund të gjeni një mjek të përgjithshëm pranë jush duke përdorur <https://www.nhs.uk/service-search/find-a-gp>. Kjo vlen vetëm për mjekët e përgjithshëm në Angli. Mjekët e përgjithshëm trajtojnë shumicën e problemeve jo-urgjente të shëndetit fizik dhe mendor. Ata punojnë me infermiere dhe profesionistë të tjerë të shëndetësisë dhe, nëse keni nevojë, mund t'ju dërgojnë për vizitë te një mjek i specializuar.

Për t'u regjistruar te një mjek të përgjithshëm, duhet t'i telefononi ose të shkoni te sporteli i recepsionit të klinikës dhe të kërkonit një formular regjistrimi. Klinika e mjekut të përgjithshëm do t'ju pyesë për adresën sepse secila klinikë ka një zonë të veçantë për të cilën kujdeset. Ata mund të kërkojnë dokumente identifikimi dhe ndonjë dokument që vërteton adresën tuaj, megjithatë ju mund të regjistroheni edhe nëse nuk i keni këto.

Ju keni të drejtën të regjistroheni te një mjek i përgjithshëm edhe nëse nuk keni dokumente ose adresë të përhershme. Mund të kërkonti nga klinika e mjekut të përgjithshëm që t'ju regjistrojë duke përdorur adresën e klinikës ose adresën e një shoku ose të një qendre të komunitetit.

Nëse keni probleme me regjistrimin te një klinikë e mjekut të përgjithshëm, tregojini recepsionistit letrën e mëposhtme.

I nderuar recepsionit i mjekut të përgjithshëm,

Do të dëshiroja të regjistrohesha në klinikën tuaj. Faleminderit që më ndihmoni për ta bërë këtë. Udhëzimet e NHS-së thonë se unë kam të drejtën që të regjistrohem edhe nëse nuk kam dokumente ose vërtetim të adresës.

Nëse nuk kam adresë të përhershme, kam ende të drejtën që të regjistrohem. Mund të më regjistroni si "pa vendbanim fiks", në adresën e klinikës, në adresën e një shoku ose në një qendër komuniteti.

Nëse nuk mund të regjistrohem në praktikën tuaj, më shkruani arsyen.

Në qoftë se keni nevojë për më shumë informacion, shikoni

<https://assets.nhs.uk/prod/documents/how-to-register-with-a-gp-asylum-seekers-and-refugees.pdf>

Rezervimi i takimit me mjekun e përgjithshëm

Nëse keni nevojë të takoheni me mjekun tuaj të përgjithshëm për një problem shëndetësor, duhet të telefononi në klinikën e mjekut të përgjithshëm dhe të flisni me recepsionistin. Mund t'ju pyesin për arsyen e telefonatës sepse kanë nevojë që t'i ndihmoni për të gjetur personin e duhur i cili do t'ju telefonojë më pas. Nëse keni nevojë për një përkthyes, pyesni recepsionistin kur t'i telefononi dhe tregojini se cila gjuhë ju nevojitet. Aktualisht, shumica e takimeve bëhen me telefon ose me thirrje me video për shkak të koronavirusit, kështu që dikush do t'ju telefonojë më pas.

Mund të ketë mënyra të tjera për të kontaktuar mjekun e përgjithshëm, të tilla si me email, nëpërmjet uebsajtit të klinikës ose duke shkuar drejtpërdrejt në klinikën e mjekut të përgjithshëm. Mund të ketë edhe vende të tjera ku mund të shkoni për kujdes mjekësor, siç janë qendrat e kujdesit në raste urgjente, qendrat e vizitave pa rezervim dhe klinikat për dëmtime të lehta. Kjo do të varet nga ajo se çfarë është në dispozicion në zonën tuaj. Nëse jetoni në Angli, mund të gjeni shërbime mjekësore pranë jush duke përdorur këtë uebsajt: <https://www.nhs.uk/service-search>.

Marrja e mjekimit

Nëse mjeku i përgjithshëm mendon se keni nevojë për mjekim, do t'ju japë recetë për këtë. Mund ta merrni atë për të marrë mjekimin në çdo farmaci. Nëse keni nevojë për mjekim afatgjatë, do të duhet të kërkonti një recetë të re nga mjeku i përgjithshëm përpara përfundimit të mjekimit. Marrja e një recete të re mund të kërkojë kohë, prandaj kërkojeni recetën të paktën një javë përpara se të keni nevojë për të.

Në Angli, disa njerëz duhet të paguajnë për mjekimin me recetë. Zakonisht, azilkërkuesit mund t'i marrin mjekimet falas, por do t'ju duhet një certifikatë HC2 për të treguar se keni të drejtë për receta falas (shih më poshtë për më shumë informacione mbi HC2). Në Irlandën e Veriut, Skoci dhe Uells, mjekimet me recetë janë falas për të gjithë.

Disa mjekime, të tilla si anti-depresivët, mund t'ju bëjnë të mos ndiheni mirë nëse e ndërpritni papritmas marrjen e tyre, kështu që duhet të siguroheni që të mos e mbaroni mjekimin ose të ndërpritni marrjen e tyre, përveçse nëse ju këshillohet nga mjeku.

Nëse keni probleme me marrjen e mjekimeve që ju nevojiten, mund të telefononi për këshilla falas në numrin e telefonit 111 të NHS-së për të kërkuar ndihmë (shih më poshtë). Edhe farmacistët mund t'ju ndihmojnë të merrni një furnizim urgjent të disa mjekimeve nëse i keni mbaruar, të tilla si inhalatorët për astmën.

Është një ide e mirë që të ruani kutitë e mjekimeve më të fundit ose t'u bëni fotografi (duke përfshirë etiketën me emrin tuaj sipër) në rast se keni nevojë t'i tregoni dikujt se çfarë mjekimi merrni zakonisht. Mjekët mund të mos jenë në gjendje t'ju lëshojnë recetë për disa lloje mjekimesh përveçse nëse kanë prova që zakonisht i merrni ato.

Shërbimi 111

Shërbimi 111 është një shërbim telefonik falas për këshilla shëndetësore. Mund të telefononi për ndihmë, për çdo problem shëndetësor jo-urgjent, në numrin 111. (Për raste urgjente, telefononi në numrin 999.) Shërbimi 111 do t'ju bëjë shumë pyetje për të përcaktuar se çfarë lloj ndihme ju nevojitet. Pastaj, do t'ju japin këshilla ose do të gjejnë dikë që t'ju telefonojë më pas për t'ju ndihmuar.

Nëse keni probleme me dhëmbët, shërbimi 111 mund t'ju tregojë se si të merrni trajtimin.

Nëse keni nevojë për ndihmë në një gjuhë tjetër, thoni fjalën "interpreter - përkthyes" dhe gjuhën që ju nevojitet, më pas qëndroni në linjë dhe ata do të gjejnë një përkthyes me telefon për t'ju ndihmuar me thirrjen.

Gjithashtu, nëse preferoni, mund të përdorni uebsajtin e 111 (<https://111.nhs.uk>). Mund të shkruani se çfarë problemi keni në anglisht dhe dikush do t'ju telefonojë më pas. Për të shfrytëzuar shërbimin e përkthimit, duhet të telefononi në numrin 111.

Farmacitë

Farmacitë mund t'ju shesin pa recetë mjekime të caktuara të tilla si qetësues ose kremra. Gjithashtu, ato mund t'ju ofrojnë këshilla mjekësore ose trajtim për disa probleme të thjeshta shëndetësore. Nëse ju mbaron një mjekim i caktuar, për shembull inhalatori i astmës, farmacistët mund t'ju ndihmojnë të merrni një furnizim urgjent.

Ndihma për shpenzimet e kujdesit shëndetësor

Nëse jeni duke marrë ndihmë nga Ministria e Brendshme, duhet t'ju kenë dhënë një certifikatë HC2. Certifikata HC2 ju lejon të siguroni receta falas, kontrollin e syve dhe kujdes për dhëmbët. Kjo do të thotë gjithashtu që mund të merrni ndihmë për shpenzimet e udhëtimit për disa takime në spital.

Nëse nuk ju është dhënë një certifikatë HC2 ose nëse keni nevojë për një kopje certifikate sepse keni humbur certifikatën apo ka skaduar, duhet të kërkonti një formular HC1 në klinikën tuaj të mjekut të përgjithshëm ose në një farmaci. HC1 është formulari që ju nevojitet për të marrë një certifikatë zëvendësuese HC2. Ju mund të porositni një certifikatë HC2 nëpërmjet telefonit duke telefonuar në numrin 0300 330 1343 ose në linjë në: <https://services.nhs.uk/apply-for-help-with-nhs-costs/apply-online>.

Koronavirusi

Simptomat më të zakonshme të koronavirusit janë një kollë e pazakonshme, humbje ose ndryshim i shqisës së shijes ose nuhatjes dhe ethe. Nëse keni një ose më shumë nga këto simptoma të koronavirusit, duhet të qëndroni në shtëpi dhe të telefononi në numrin 119 për të kërkuar një test. Nëse thoni "interpreter – përkthyes" dhe gjuhën që ju nevojitet, do të lajmërohet një përkthyes për përkthimin me telefon për t'ju ndihmuar gjatë telefonatës. Gjithashtu, mund të rezervoni një test në linjë në: <https://www.gov.uk/get-coronavirus-test>.

Aktualisht, duhet të regjistroheni te një mjek i përgjithshëm që të ftoheni për vaksinën e koronavirusit. Vaksina e koronavirusit është efikase dhe e sigurt.

"Doctors of the World" (Mjekët e Botës) kanë prodhuar broshura për vaksinën në shumë gjuhë, në dispozicion në: <https://www.doctorsoftheworld.org.uk/coronavirus-vaccine-information>.

NHS-ja ka prodhuar video në lidhje me vaksinën në shumë gjuhë të ndryshme, në dispozicion në: <https://www.england.nhs.uk/london/our-work/covid-19-vaccine-communication-materials>.

Urgjencat

Urgjenca Mjekësore është për dëmtimet serioze dhe rastet mjekësore urgjente. Për shembull, njerëzit mund të shkojnë tek Urgjenca Mjekësore nëse mendojnë se kanë thyer një kockë, kanë dhembje gjoksi ose kur kanë ndjesinë e vetëvrasjes. Nuk keni nevojë për të lënë takim për të shkuar tek Urgjenca Mjekësore, por do t'ju duhet të prisni për t'u vizituar (përveçse nëse problemi përbën rrezik për jetën).

Nëse keni nevojë që te ju të vijë një autoambulancë për arsye urgjente (zakonisht nëse jeta juaj ose e dikujt tjetër është në rrezik), duhet të telefononi në numrin 999. Telefonata në numrin 999 është falas. Kur të telefononi, do t'ju pyesin "Për cilin shërbim keni nevojë?". Duhet të thoni "autoambulanca" (ose policia apo zjarrfikëset për llojet e tjera të urgjencave). Do t'ju pyesin se ku jeni, cili është numri i telefonit dhe çfarë ka ndodhur. Qëndroni në telefon derisa të përfundojnë telefonatën sepse mund t'ju duhet t'ju japin këshilla ose t'ju bëjnë më shumë pyetje ndërsa prisni që të vijë autoambulanca.

Problemet e shëndetit mendor

Mjekët e përgjithshëm mund t'ju japin me recetë mjekim për problemet e shëndetit mendor dhe mund t'ju dërgojnë për terapi bisedore ose për të takuar një specialist të shëndetit mendor. Nëse ju jepet me recetë mjekim për problemet e shëndetit mendor, është e rëndësishme që të vazhdoni ta merrni derisa mjeku t'ju thotë që ta ndërpritni.

Nëse keni probleme për shkak të një traume ose torture në të kaluarën, si p.sh. makthe ose kujtime që ju krijojnë ankth, kërkojini mjekut të përgjithshëm që t'ju drejtojë diku që të trajtoheni për këtë. Ky mund të jetë një ekip i shëndetit mendor lokal, një shërbim për traumat ose një shoqatë bamirëse, siç është "Liria nga Tortura" (Freedom from Torture) (www.freedomfromtorture.org) ose Helen Bamber Foundation (www.helenbamber.org).

Mind është një organizatë bamirëse e shëndetit mendor e cila ka një shërbim informacioni telefonik. Ju mund t'u telefononi për të mësuar më shumë rreth problemeve të shëndetit mendor dhe ku mund të kërkonti ndihmë. Numri i tyre është 0300 123 3393 dhe linja është e hapur nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 6 të pasdites, nga e hëna deri të premten. Kur të telefononi, mund t'u kërkonti një përkthyes. Operatori juaj telefonik do t'ju tarifojë telefonatën për thirrjen në numrin e tyre, por mund t'u dërgoni edhe email në info@mind.org.uk.

Nëse mendoni se shëndeti juaj mendor është përkeqësuar dhe keni nevojë për ndihmë urgjente, telefonojini mjekut të përgjithshëm në numrin 111 ose shërbimit aktual të shëndetit mendor, nëse keni një të tillë. Nëse nuk arrini t'i kontaktoni, shkoni tek Urgjenca Mjekësore.

Problemet me sigurimin e kujdesit mjekësor

Një mjek i përgjithshëm mund të refuzojë t'ju regjistrojë vetëm nëse lista e tij e pacientëve është e mbushur (nuk ka vend) ose nëse jetoni jashtë zonës së tij. Nëse ndodh kjo, duhet të përpiqeni të regjistroheni në një klinikë tjetër pranë vendit ku jetoni.

Nëse keni probleme me regjistrimin te një mjek i përgjithshëm ose nëse keni probleme të tjera për sigurimin e kujdesit mjekësor, mund të kontaktoni Migrant Help-in (Ndihma për Emigrantët) në numrin 0808 8010 503 ose Health Watch-in (Kujdesi për Shëndetin) në numrin 03000 683 000.

Uebajti i Health Watch-it (www.healthwatch.co.uk) ka këshilla në shumë gjuhë të ndryshme. Në zonën tuaj mund të ketë gjithashtu grupe që mbështetin refugjatët apo azilkërkuesit ose shoqata bamirëse të cilat mund t'ju ndihmojnë.

Doctors of the World-i kanë një linjë këshillash klinike, e cila u jep njerëzve këshilla falas për kujdesin shëndetësor pavarësisht nga statusi i tyre i emigrimit. Numri i telefonit falas është 0808 1647 686. Klinika është e hapur nga ora 10 e mëngjesit deri në orën 12 të drekës, nga e hëna deri të premten. Ato ofrojnë përkthyes për njerëzit që kanë nevojë.

Lista e kontrollit gjatë zhvendosjes

Këtu janë disa gjëra që duhen mbajtur mend nëse po zhvendoseni për të banuar në një zonë tjetër:

- Merrni me vete mjekimin, kutitë ku është futur mjekimi, çdo dokument mjekësor dhe certifikatën HC2.
- Mbajini fotografitë e këtyre gjërave si kopje rezervë në telefon.
- Sa më parë që të mundeni pas zhvendosjes, regjistrohuni te një mjek i përgjithshëm. Mos prisni derisa të keni nevojë për një takim ose mjekim për t'u regjistruar te mjeku i përgjithshëm.
- Mbani në telefon emrin dhe adresën e mjekut tuaj të përgjithshëm.
- Nëse e dini numrin tuaj të NHS-së (një numër 10-shifror që zakonisht jepet me letra nga NHS-ja) mbajeni në telefon pasi do të ndihmojë mjekët e rinj që të kenë mundësinë e hyrjes në të dhënat tuaja mjekësore.
- Gjeni se ku janë qendrat më të afërta të Urgjencës Mjekësore dhe qendrat pa rezervim në zonën ku jeni zhvendosur.

Falënderime

Forrest Medicolegal Services (Shërbimet Mjeko-ligjore Forrest) vlerësojnë me mirënjohje ndihmën dhe mbështetjen e organizatave të mëposhtme për përgatitjen e kësaj broshure:

Care for Calais (Kujdesi për Calais), Committee of Residents of Penally (Komiteti i Banorëve të Penally), Covid-19 Infographics, Doctors of the World (Mjekët e Botës), Freedom from Torture (Liria nga Tortura), Helen Bamber Foundation (Fondacioni Helen Bamber), Medact, Médecins Sans Frontières UK and Migrants Organise (Mjekët pa Kufij të MB-së dhe Organizata e Emigrantëve). Përgjegjësia për përmbajtjen e kësaj broshure i takon Forrest Medico-legal Services. Forrest Medico-Legal Services është një Shoqëri e Interesit të Komunitetit (Shtëpia e Shoqërive Nr. 10017081).